



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, 64, nenin 70 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 6, paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 dhe nenin 8 paragrafi 1 të Rregullores Zgjedhore Nr.02/2024, Emërimi, Përbërja dhe Funksionimi i Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve, si dhe kërkesës, të datës 27.01.2025, të subjektit politik Lëvizja VETËVENDOSJE! në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 28.01.2025, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për emërimin dhe zëvendësimin e anëtarit të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) në Komunën e Obiliqit

- I. Z. Selim Asllani emërohet anëtar i KKZ-së në komunën e Obiliqit nga subjekti politik VETËVENDOSJE! duke e zëvendësuar z. Berat Gashi, nga i njëjti subjekt politik, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 9 Shkurt 2025.
- II. Mandati i anëtarit të emëruar të KKZ-së, do të fillojë nga data e emërimit sipas këtij vendimi dhe do të përfundojë pesëmbëdhjetë (15) ditë pas certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve, përveç nëse mandati i KKZ-së ndërpritet para përfundimit të afatit ose zgjatet me vendim të KQZ-së.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Me vendimin e KQZ-së Nr.01/289-2024, të datës 16.09.2024, z. Berat Gashi nga subjekti politik Lëvizja VETËVENDOSJE! është emëruar anëtare e KKZ-së, ndërsa me kërkesën e subjektit politik në fjalë, të datës 27.01.2025, ka kërkuar zëvendësimin e ti për arsye se me vendimin e PZAP-së, Nr. Anr.32/2025 të datës 15.01.2025, i është ndaluar pjesëmarrja në zgjedhje, si kandidat apo edhe pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor për periudhën 2 (dy) vjeçare. Andaj, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, 28.01.2025

Kreshnik RADONIQI
Kryesues i KQZ



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 59 paragrafi 4.1, nenin 63, nenin 107 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 28.01.2025, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Dizajnit dhe Slloganit për Fushatën e Informimit Publik

- I. Miratohet dizajni i slloganit për fushatën e informimit publik, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 9 shkurt 2025.
- II. Dizajni i slloganit si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimit.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 28.01.2025

Kreshnik RADONIQI
Kryesues i KQZ



ZGJEDHJET PËR KUVENDIN
E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

9 SHKURT

VOTA JOTE PËR KOSOVËN

2025



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, 64 dhe nenin 65 paragrafi 3, të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 28.01.2025, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Rekomandimit për Autorizimin e Drejtorit të Sekretariatit të KQZ-së për Nënshkrimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit

- I. Miratohet Rekomandimi i Këshillit të Operacioneve Zgjedhore (KOZ) që të Autorizohet Drejtori i Sekretariatit të KQZ-së, që të nënshkruaj Marrëveshjen e Bashkëpunimit, ndërmjet KQZ-së dhe Autoritetit Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP).
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, për zbatimin e këtij vendimi.
- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 28.01.2025

Kreshnik RADONIQI

Kryesues i KQZ





Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, nenin 64.2 dhe nenin 96 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe nenin 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 17/2024, Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 28.01.2025, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Mbylljes së Qendrës së Votimit në Përfaqësi Diplomatike

- I. Në Qendrën e votimit në përfaqësitë diplomatike në: Ankara, Turqi, në Kambara, Australi, dhe Iowa, SHBA, për arsye të numrit të vogël të votuesve të regjistruar nuk do të organizohet procesi i votimit, për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, që do të mbahen më 9 shkurt 2025.
- II. Udhëzohen votuesit e qendrave si në pikën I t këtij vendimi të dërgojnë votat në kutitë postare jashtë Kosovës.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 28.01.2025





Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, si dhe nenin 83 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe nenin 2 të Rregullores Zgjedhore Nr.5/2024, Themelimi dhe Menaxhimi i Qendrave të Votimit, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datën 28.01.2025, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Rekomandimit për Ndërrimin e Lokacionit të Qendrës së Votimit (QV) në Mitrovicën e Jugut

- I. Miratohet rekomandimi i Kryesuarit të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) në Mitrovicën e Jugut, për ndërrimin e lokacionit të Qendrës së Votimit nga objekti 1127 në fshatin Mazhiq në objektin shtëpi private -Shtëpia e Pajazit Jonuzit. Rr. "3 Dëshmoret" në fshatin Mazhiq.
- II. Rekomandimi si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 28.01.2025

Kreshnik RADONIQI
Kryesues i KQZ



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosovo

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 59, nenin 63 dhe nenin 113 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 28.01.2025, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Pagesës për Faturën e Anëtarësisë në Rrjetin e Institucioneve Elektorale Nacionale Frankofone (RECEF)

- I. Miratohet pagesës për faturën e anëtarësisë në Rrjetin e Institucioneve Elektorale Nacionale Frankofone (RECEF), në shumë 2, 500 euro.
- II. Fatura si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimit.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 28.01.2025

**Kreshnik RADOMIQI**
Kryesues i KQZ